



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 32 /2025

Datë: 30/01 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/ 01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34, 18 Nëntor 2022), duke u bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, dhe dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr.82/2024, të datës 15.04.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2 e Vendimit Nr.82/2024, të datës 15.04.2024, si në vijim:

“2. Obligohet Komisioni nga pika 1 e Vendimit Nr.82/2024, të datës 15.04.2024 të përcaktoj listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e pranueshmërisë në shërbimin noterial në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë dhe Ligjit Nr. 08/L-272 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149.”

2. Ky Vendim është pjesë e Vendimit Nr.82/2024, të datës 15.04.2024.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika,
- Arkiviot të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 82 /2024
Datë: 15/04 /2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për zgjedhjen e noterëve (më tej: Komisioni) në këtë përbërje:

- 1.1 Sefadin Blakaj, Kryetar, zëvendëskryetare, Arijeta Ukaj-Dervishaj;
- 1.2 Arta Morina-Mustafa, anëtare, zëvendësanëtar, Bilgaip Maznikar;
- 1.3 Nikollë Komani, anëtar, zëvendësanëtare, Shpresa Emra;
- 1.4 Emine Abdyli-Pozhari, anëtare, zëvendësanëtare, Majlinda Belegu;
- 1.5 Lulzim Beqiri, anëtar, zëvendësanëtare, Trëndelina Qorraj.

2. Obligohet Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi të përcaktoj listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet e pranueshmërisë në Shërbimin Noterial në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë.

3. Mandati i të emëruarve në pikën 1 të këtij vendimi zgjatë tre (3) vjet, pa të drejtë rizgjedhje.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Profesione të Lira;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*